



Akelius

unicef 
for every child

A collection of colorful, stylized school and office supplies is arranged around the central text. Items include a yellow folder, a purple folder, a red alarm clock, a yellow lightbulb, a yellow star, a magnifying glass, a red pencil, a yellow pencil, a red backpack, a blue ruler, and a computer monitor displaying a green mountain landscape with icons. The text 'Mezi pres të jem në "Akelius"' is centered in blue.


Mezi pres të jem në
"Akelius"

Franci jeton në periferi të Tiranës. Prej disa vitesh familja e tij është vendosur në një apartament pranë banesave sociale në Shkozë. 10 vjecari vjen cdo ditë në shkollë, por nuk di ende të shkruajë e të lexojë rrjedhshëm në gjuhën shqipe. Por Franci që dëshiron të jetë një mekanik i mirë makinash, është një ndër nxënësit që ndjek rregullisht orët e “Akeliusit” në shkollën fillore, Androkli Konstallari.



Franci, në kabinetin "Akelius", shkolla "Androkli Kostallari"

Më pëlqen të luaj, dhe të mësoj anglisht, thotë Franci. Unë nuk kam as internet dhe as tabletë në shtëpi. Mezi pres të vij në orën e Akeliusit, ku mund të luajme me tabletat por edhe të mësojmë anglisht. Në fillim mësova shkronjat, pastaj përmes lojrave fiksoj edhe fjalët tregon Franci.



Franci ka mësuar shumë fjalë në gjuhën angleze. Mësuesja e anglishtës Kisida Shemsiu tregon se ai me shumë pak punë ka arritur të mësojë shumë fjalë por edhe të kuptojë pyetje të thjeshta përmes programit Akelius. Mësuese Kisida thotë se Franci ka vështirësi në të lexuar dhe në të shkruar in e gjuhës shqipe, por në klasën e saj ai vjen rregullisht dhe përparimi është I dukshëm.

Familja e Francit, gjatë pandemisë, është përballur me vështirësi të mëdha ekonomike. Prindërit e tij janë të papunë, dhe vështirësia më e madhe ishte sigurimi I ushqimit për Francin dhe motrën e tij më të madhe. Franci është një ndër fëmijët e shkollës Androkli Kostallari që përfitojnë nga projekti Akelius, I cili nxit të mësuarin përmes lojës. Akelius po zbatohet për here të parë në Shqipëri I mbështetet nga Unicef dhe Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

